



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:274649

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05533012

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, sipas gjyqtarit Musë Povataj me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarit, E.. Q.. për shkak të veprës penale të ngacmimit nga neni 182 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme PP/II-nr.3095/19 të datës 09.02.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 05.12.2024, 06.02.2024 dhe 27.02.2024 të hapur për publikun, në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të akuzuarit E.. Q., të dëmtuarit B.. S.. me datë 01.03.2024 mori dhe shpalli publikisht ndërsa me datën 02.04.2024 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.. Q.. i lindur më, me numër, i biri i H.. Q.. dhe nënës Sh.. Q.., e gjinisë S.., ka të kryer shollën e mesme, menagjer i firmës, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar babë i 3 fëmijëve, me vendbanim në B.., shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, ka qëndruar ne paraburgim nga data 21.11.2019 deri me datë 21.02.2020.

Konform nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së.

LIROHET NGA AKTAKUZA

Për shkak se:

Nga data 08.06.2016 e në vazhdimësi gjer me datën 21.11.2019, në fsh. B.. K. Dragashit, me qëllim të ngacmimit, përfshihet në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme dhe gjatë këtyre veprimeve tjetrin e vë nën shqetësim të madh emocionale dhe atë të dëmtuarin B.. S.., në atë mënyrë që, pasi i dëmtuari B.. në cilësinë e Prokurorit të Shtetit në vitin 2016 kishte mbrojtur një aktakuzë , ku palë ka qenë edhe i pandehuri E.. i cili ishte i pakënaqur dhe nga ky moment i pandehuri, me qëllim të ngacmimit deri me datën 21.11.2019 fillon të shkruaj komente në portale të ndryshme në rrjetin social facebook vazhdimisht se kinse i dëmtuari B..

është "i korruptuar, udbash, sekser, hajdut, berllog, shantazhues, shpifës, manjak, kriminel, servil, mut i madh, bënë masakra ne drejtësi, njeri i R..., bashkëpunon me hajdut, bënë pazare me të pandehur, gjithmonë i'a ndërron vendin viktimës me kriminelin, familja e tij janë spiun dhe fjalë të tjera, ashtu që te dëmtuarin B.. S.. e ve nen shqetësim të madh emocional.

-me çka kishte për të kryer veprë penale të ngacmimit nga neni 182 par. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Të pandehurit i kthehet telefonin S.. D.. ngjyrë e b... IMEI 1 3...../.. dhe IMEI 2: 3...../.... menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.841/23 të datës 19.05.2023 ndaj të akuzuarit E.. Q.. për shkak të veprës penale të ngacmimit nga neni 182 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 18.02.2020 gjykata Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ku i pandehuri është deklaruar i pafajshëm.

Kjo çështje penale me datë 28.10.2021 pas kërkesës së gjykatës Themelore në Prizren është pranuar për procedim në këtë gjykatës nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë.

Me datën, 06.02.2024 gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli, të akuzuarit E.. Q.. dhe të dëmtuari B.. S.. , ndërsa seancat e datës 05.12.2024 dhe 27.02.2024 është mbajtur ne mungesë të të dëmtuarit B.. S.. i ftuar nga gjykata ne mënyrë të rregullt pa e arsyetuar mungesën.

Prokurorja e shtetit Ardiana Veseli në fjalën përfundimtare drejtpërsëdrejti procesverbal ka deklaruar: se fjalën përfundimtare e kam përgatitur ne formë te shkruar ku një kopje te mjaftueshëm për gjykatës dhe palët. E njëjta do te jetë pjesë përbërëse e shkresave te lende duke i propozuar gjykatës qe te pandehurin ta shpall fajtor për veprën penale për te cilën akuzohet , po ashtu me rastin e matjes e dënimit gjykatës i propozoj qe rrethanë renduese te marr shkallën e lart te dashjes, mënyrën e kryerjes se veprës penale, se i njëjti është dënuar edhe me par për vepra penale dhe atë për veprë penale kanosje P.nr.1367/16 te date 24.10.2016 për veprën penale falsifikim i dokumenteve P.nr.773/17 te date s 08.08.2019 si dhe P.nr.1289/18 për veprën penale kanosje, andaj mbetemi ne tersi pran aktakuzës, përshkimit faktik dhe juridik te veprës penela m, duke i propozuar gjykatës qe te pandehurin ta shpall fajtor duke e përcaktuar edhe dënimin

për këtë vepër penale, ndërsa me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit si rrethanë rëndësuese e të merret parasysh dashja e lart të pandehurit në kryerjen e kësaj vepre penale.

I akuzuarit E.. Q. në fjalën përfundimtare drejtpërsëdrejti procesverbal ka deklaruar: fjalën time përfundimtare e kam përgatit në formë të shkruar dhe i propozoj gjykatës që e njëjta të jetë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, duke i propozuar gjykatës që të më liroj nga akuza dhe duke shtuar se sa i përket të kaluarës penale për veprën penale e cila i referohet falsifikimit unë jam i dënuar mirëpo lëndën e kam në gjykatë supreme.

2. Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të drejte të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, të dëmtuarën B.. S., ndërsa në gjykatë gjatë shqyrtimit janë administruar këto prova materiale; raporti i ekspertizës dt. 08.01.2020; kërkesa por mbështetje institucionale dt. 26.11.2019; Shënimi zyrtar dt. 18.11.2019; Raporti i oficerit rr. E.. P.. nr. 1989 dt. 20.11.2019; Raporti i shpejt i dt. 21.11.2019; Fotografitë e shkresave të lëndës; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve; Letra e hapur për Prokurorinë Themelore në Prizren e të pandehurit E.. Q.; Shikohet CD e ekzaminimit të telefonit të të pandehurit, si dhe gjykata ka dëgjuar mbrojtën e të akuzuarit.

2.1 Deklaratat e dëshmitareve

2.1.1. I dëmtuari B.. S. gjatë shqyrtimit gjyqësor në cilësi të dëshmitares ka deklaruar se: profesioni e Prokurorit e ushtroj që nga viti 2015, të pandehurin e njoh që nga viti 2016, dhe me të njëjtin jemi në procese gjyqësore në vazhdimësi, ngase i njëjti në vitin 2016 derisa kam qenë duke përfunduar në gjykatë i njëjti në përfundim me rastin e nënshkrimit të procesverbalit me është drejtuar me gishtin tregues dhe më ka thënë se ki me pa se kush është E.. Q., unë shprehja shqetësimin tim tek gjyqtari çështjes dhe nga i njëjti kam kërkuar që ta ndaloj të pandehurin nga se ka kryer vepër penale te kanosjes se personit zyrtar, ne atë rast cilësia e të pandehurit ka qenë në cilësi të dëmtuarit, pas kësaj i njëjti përmes facebook ka kanos djalin tim vajzën dhe mua lidhur me rastin i cili ka qenë në d.. me të cilën çështje është në zhvillim e sipër proceduar në gjykatën themelore në G., pas këtij rasti i njëjti në vazhdimësi neper portale dhe media ka vazhduar komentimet e ndryshme përkitazi me mua personalisht, këto nuk kanë përfunduar me këtë çështje por i njëjti vazhdon edhe sot e kësaj dite të komentoj gjyqtar dhe prokuror, sistemin gjyqësor pa kursyer fjalë dhe fjalor denigruarës, poshtërues dhe të gjitha këto i bën me qëllim të linçimit dhe shprehjeje se mllefë dhe urrejtjes kundër gjyqësorit, gjyqtarit të caktuar dhe prokurove të cilët kanë pasur punë me çështjet e të njëjtit, kjo situatë siç e thash edhe më lart vazhdon edhe sot e kësaj dite,

Tutje i dëmtuari ka deklaruar se: nuk kam facebook, mirëpo me komentet të bëra nga i pandehuri jam njoftuar nga kryeprokuror i prokurorisë në Prizren, nga koleget e mijë prokurorë dhe nga

disa gjyqtar, komentet ishin drejtuar kundër meje dhe familjareve të mijë, unë dhe familjaret jemi të shqetësuar jashtëzakonisht dhe lidhur me këto ngacmime e kam njoftuar kryeprokurorin e prokurorisë themelore ne P.. duke e respektuar parimin e hirësisë, pastaj kam njoftuar kryeprokurorin e prokurorisë se Kosovës z. A.. L., gjithashtu kam njoftuar edhe kryetarin e komisionit pran Këshillit prokuroria i cili komision është i formuar lidhe me trajtimin e kanosjeve ndaj prokuroreve dhe për këtë kanosje e kam njoftuar këtë si kryetar.

Tutje i dëmtuari ka deklaruar se: lidhur me këto shqetësime ndaj meje është iniciuar vetëm, ky rast për te cilin jemi këtu, dhe nuk e kam par te arsyeshme qe për çdo reagim ose shkrim te tij te hapim raste te reja, aq me tepër reagimet e tija nuk përfundojnë vetëm përmes shkrimeve këtë e them ngase para disa muajve gjate sezonit te verës vajza ime ka shpreh shqetësimin se dikush nga rruga e ka përcjell deri ne momentin kur ajo ka hyr ne shtëpi, për këtë e njëjta me ka njoftuar kur jam kthyer nga puna e kam pyet ne detaje se a njih këtë person dhe si duket nder shenjat karakteristike më ka përshkruar se i njëjta ishte tullac pa flok, dhe pasi i kam prezantuar foton e te pandehurit me siguri te plot ka vërtetuar se atë e kishte ndjek ky person, dhe ky rast ka ndodh ne vitin 2023 ne stinën e verës,

Tutje i dëmtuari ka deklaruar se: i pandehuri ka shkruar ne llogari te fëmijëve te mijë mesazhe kanosëse, duke ju thënë se ne qoftë se nuk shukatet babi juaj unë do te merrem me ju, i pandehuri ne periudhën për te cilën akuzohet prej vitit 2016 ne vazhdimësi duke komentuar me ka shqetësuar dhe rasti i fundit ne gazetën Sinjali ku komenton: ama qaq qen janë këta ne Prizren saqë se pret kush vetingun, unë disa gjyqtareve dhe prokuroreve ne Prizren kom qefë me jau mbarsu familjen, disave duhet me jau mbarsu grat ne hotele, vajzat ne park dhe nenat ne varr, kjo është në vitin 2024.

2.2 Provat materiale

2.2.1. nga kërkesa por mbështetje institucionale dt. 26.11.2019 dhe Shënimi zyrtar dt. 18.11.2019 gjykata ka vërtetuar se i dëmtuari B.. S.. i është drejtuar Këshillit Prokurorial të R. Kosovës, ku i shpreh shqetësimet e tij lidhur me veprimet e vazhdueshme të të pandehurit E.. Q.. dhe kërkon mbështetje.

2.2.2. nga Raporti i oficerit rr. E.. P.. nr. 1989 dt. 20.11.2019; Raporti i shpejt i dt. 21.11.2019 gjykata ka konstatuar se të pandehurit i janë kontrolluar rrjetet sociale dhe me pas i janë kopjuar shënime dhe postimi ne të cilat i pandehuri i është drejtuar me fjalë fyese dhe ofenduese drejtim të prokurorit B.. S.. dhe familjes së tij dhe këto veprime i dyshuari i ka përsëritur çdo here";

2.2.3. nga fotografitë e shkresave të lëndës, është vërtetuar i pandehuri ka bërë koment në Betimi për Drejtësi në artikullin akuzohej se vodhi 20 euro, prokurori tërhiqet nga ndjekja penale ndaj tij, duke komentuar se "*o ky mut prokuror paska bo Pazar, B.. S.. është prokuror sekser, ma idiot*

se bon nona, shumë pis, klloshar është, veç nëse ka naj interes i bon kto sende, përndryshe gjithmonë ja ndërron vendet viktimën e ben kriminel, e kriminelin viktimë'.

I pandehuri po ashtu ka komentuar tek E.. E.. C.. duke shkruar se: *"qka po thu bre, po në Prizren është një prokuror B.. S., është udbash, është hajdut, edhe ligjin e benë e qysh donë vet, një qytet është tu ngren, dhe smerret kush me atë bërlllok, bile edhe koleget prokuror e mbrojnë, qe është shume qudi.*

I pandehuri po ashtu ka komentuar tek E.. E.. C.. duke shkruar se: *"shumë vështir ishalla hyn vetingu dhe ligji lustracionit, me ligjin e lustracionit udbashi B.. S.. mbetet jasht institucioneve, me veting shkon mbrapa grilave udbashi e hajduti, kojshia i pa ndashëm i I.. D.. B.. S., vllau i makrropisit spiunit Hazër susurit'.*

I pandehuri po ashtu ka komentuar në Prizrenpress's post tek Z.. V.. duke shkruar se: *"drejtësia e vonuar nuk është drejtësi, ne Prizren prokurori i shtetit udbashi B.. S., është shantazhues, hajdut, shpifës e kriminel, me një golf dysh ku me dit sa njërin e ka shantazhue ne qytet, tu ju ra makinave e tu ju marre lek njerëzve e tu rregullue pa lek defektet'.*

I pandehuri po ashtu ka komentuar tek E.. E.. C... duke shkruar se: *"është biri r.. s. një qetniko fashist i betuar i r., vllau i h.. s., poniashtu qetniko fashist i përbetuar i R.. M. edhe s.. m....., mandej është servil disa njerëzve tu e dit çfarë familje udbashesh janë e kanë privilegjuar ne pozitën e prokurorit te shtetit, ky mut nuk paguan asgje ne qytet, barna falas, parking falas qebapa falas është ma i korruptuar se gjysma e inspektoreve te P..';*

I pandehuri po ashtu ka komentuar tek RTV Besa, duke shkruar se *"nëse është prokuror i rastit B.. S.. udbsahi famshëm nga Prizreni, për dy byrek me mish e lëshon arsimitarin te lir, ne mungesë te fakteve, dihet. Është një mut i madh i zhurit qe jeton ne P.. J.. njerëz te privilegjuar te r..';*

I pandehuri po ashtu ka komentuar tek A.. K., duke shkruar se *"ky mut prokuror është familje udbashesh, vllau i tij hazeri e ka perpilue dhe nënshkrue suprimimin e Kosovës... "; "me çfarë not është vlerësuar prokurori udbashi B.. S.. i cili vazhdimisht bashkëpunon me hajduta, është i sterkorruptuar dhe shpifës e manjak'.*

Po ashtu i pandehuri ka bërë koment në Betimi për Drejtësi tek shkrimi "Gjykata e kthen sërish në plotësim aktakuzën, Prokurorja: "A jemi në diktaturë", tensione në gjykim... duke shkruar; *"masakrat ne drejtësi te Prizrenit kur i benë prokurori B.. S., nuk mundet me i la ,lumëbardhi' ., pastaj ka komentuar ; "ishalla nuk është prokuror i rastit B.. S.. se i gjobit , pronaret pse nuk i kan ruj delet dhe gjedhet'.*

I pandehuri po ashtu ka komentuar në portalin Prizreni.info tek shkrimi "Paralajmëron P.. në P.., kjo i gjen ata që keqpërdorin votat", duke shkruar: "*prokurori B.. S.. për 10 qebapa i mshel sytë para keqpërdorueseve*'

I pandehuri po ashtu ka komentuar tek RTV Besa duke shkruar "*nëse është prokuror i rastit B.. S.. u.. famshëm nga P.., për dy byrek me mish e leshon arsimitar të lir, ne munges të fakteve, dihet. Eshte nje mut i madh i zhurit qe jeton ne P.. J.. njerëz të privilegjuar të r....*

I pandehuri po ashtu ka komentuar tekë S.. K.., duke shkruar "*mi shkue këto lendet prokurorisë Prizrenit, e me qenë prokuror i rastit udhëbashi B.. S.., thotë shko paguaj qatë ne qebaptore nja 100 kg qebapa edhe u krye kjo punë*";

I pandehuri po ashtu ka komentua tekë S.. K.., duke shkruar "*ku ka prokuror bre është prokuror udhëbashi B.. S.. vëllai i tij e ka shitur Kosovën me suprimimin e autonomisë, për mutin prokurorin B.. S.. kjo është cikrim, popullata po hesht këtu është defekti*".

2.2.4. nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve 2019-GI- 81 dhe nga CD e ekzaminimit të telefonit të të pandehurit, është vërtetuar se të pandehurit i është konfiskuar telefonin S.. D.. ngjyrë e bardhë IMEI 1 3..../.... dhe IMEI 2: 3..../.. dhe pas ekzaminimit është konstatuar se pas analizimit të telefonit të të pandehurit E.. Q.. dhe raportin e ekspertizës, është cekur se janë kopjuar 19 raste se si i pandehuri kontakton me persona të ndryshëm rreth rasteve të tij, dhe po ashtu janë në këtë raport të ekspertizës të dt.08.01.2020 janë cekur karakteristikat e telefonit.

2.3 Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari E.. Q.. në mbrojtjen e tij dhënë në shqyrtim gjyqësor, në mes tjerash ka thënë se: me data e 04.05.20216 kam qenë i dëmtuar në një çështje penale ku mua me eshët vjedh një kombi nga një mik i prokurorit B.. S.. ngase këta rrinë bashkë, bëjnë dallavere bashkë dhe aj person është I.. B.., unë kam pas një padrejtësi nga gjykata dhe unë kam shkruar në paraburgim u kam qëndruar 15 ditë për kanosje. Komentet neper rrejte sociale kanë ardhë si rezultat i prokurorisë dhe gjykatës, fjalët e cekuar si në dispozitiv të aktakuzës janë epitete të cupilat iu takojnë të dëmtuarit dhe këto i kam shkruar sepse i dëmtuari ka dalë në kallxo.com se kemi të bëjmë me një kriminel të natyrës së lartë.

Ndërsa për rastin ku kam çenduruar në paraburgim jam shpallur i pafajshëm, për këtë unë e kam vendimin, sa i përket kanosjes së fëmijëve të të dëmtuarit unë nuk e kam bere këtë, ndërsa ato i kam bere vet B.. S... Arsyet pse i kam jep ato komente është se i dëmtuari me ka montu procese, dhe atë për një veturë e cila ka qenë origjinal mirëpo unë jam akuzuar gjeja se i kam ndërruar numrat shasis, dhe atë për një rast me një kojshi në të cilën kam intervistuar në cilësi të prindit

,numri i akuzave ndaj meje rritej unë incizova një mjeshtër qe tregonte se i dëmtuari njehet me I.. B...

Komentet e bëra nga ana ime kane pas te bëjnë me njoftua opinionin se kem i te bëjmë me një makineri kriminale te përsosur dhe te pa prekshëm nga ana gjyqësorit, mirëpo këta me dashje kane bërë ngacmim sepse nuk ka ngacmimi sepse vepra penale është kur ne mënyrë direkte ja zen rrugën, i shkon ne pune , i shkoj ne punë apo restorant etj, unë edhe sot e tutje vazhdoj te komentoj sepse po me behën padrejtësi.

Ndërsa ne pyetje të Prokurorisë i pandehuri ka deklaruar; a është e vërtet se me te dëmtuarin jemi taku ne vitin 2016 ne gjykatë Prizren ku kamë që ne cilin e palës së dëmtuar, qe nga ajo kohë a kamë ber shkrime dhe komente kundër te dëmtuarit – prokuror B.. S.., kam bërë komentet ne portalin Betimi për drejtësi, të komentuesit E.. E.. K., kam komentuar tek personi A.. K.. për prokurorin ne fjalë, po ashtu tekë tek Betimi Për drejtësi ..., masakrat, ndërsa tekë S.. K.. i nuk i kujtohet, mirëpo ka shtuar se aty ka pas komentues tjerë edhe më te këqij mirëpo qëllimi ka qenë mem ndjek mua penalisht, ne asnjë mënyrë nuk mendoj së është shqetësuar i dëmtuari ngesë ne vazhdimësi shkruan Komete për ta, nuk me vjen keq sepse i dëmtuari ma ka shqetësuar dhe me ka bërë dem.

3. Elementet e veprës penale

Me nenin 182 par 1 të KPRK-së, është parashikuar se veprën penale ngacmim e kryen: kushdo që përfshihet **në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit**, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional. Ndërsa par. 2 i nenit 182 ka përcaktuar: kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet ndaj një personi me të cilin **kryesi ka qenë apo është në marrëdhënie familjare** ose ndaj një ish anëtari apo anëtari aktual të familjes.

Ndërsa para. 4 i po të njëjtit nënë ka përcaktuar se: vëmendja apo komunikimi nga paragrafi 1. i këtij neni mund të përfshijë përcjelljen apo qëndrimin në pritje; shfaqjen e vazhdueshme te shtëpia, shkolla, puna apo qendra rekreative; përsëritjen e thirrjeve telefonike; dërgimin apo lënien e porosive; dërgimin e mesazheve telefonike, letrave postare apo postës elektronike; ose lënien apo dërgimin e dhuratave të padëshiruara apo të gjësendeve tjera.

4. Gjendja e vërtetuar faktike

Gjykata pas administrimit të provave, analizimit të tyre me shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se: në veprimet e të akuzuarit për të cilat ngarkohet nuk përbëjnë vepër penale, për të cilën është akuzuar, për shkak se me provat të cilat janë administruar nuk mund të mbështetet dyshimi i bazuar mirë në drejtim të elementeve të veprës të ngacmimit nga neni 182 par. 1 të KPRK-se.

Prandaj nga dëgjim i të dëmtuarit, administrimi i provave materiale dhe mbrojtja e të akuzuarit, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të pandehurit nuk formohen elemente të veprës penale nga neni 182 par. 1 të KPRK-së, ngase nga të gjitha këto prova nuk është vërtetuar se i pandehuri është përfshirë në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional.

E par. 4 i po të njëjtit nënë ka përcaktuar se: vëmendja apo komunikimi nga paragrafi 1. i këtij neni mund të përfshijë përcjelljen apo qëndrimin në pritje; shfaqjen e vazhdueshme të shtëpiake, shkolla, puna apo qendra rekreative; përsëritjen e thirrjeve telefonike; dërgimin apo lënien e porosive; dërgimin e mesazheve telefonike, letrave postare apo postës elektronike; ose lënien apo dërgimin e dhuratave të padëshiruara apo të gjësendeve tjera.

5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata ka vlerësuar deklaratën e të dëmtuarit i cili ndër të tjera ka deklaruar; ***nuk kam facebook, mirëpo me komentet të bëra nga i pandehuri jam njoftuar nga kryeprokurori i prokurorisë në P., nga koleget e mijë prokurorë dhe nga disa gjyqtar, komentet ishin drejtuar kundër meje dhe familjare të mij, unë dhe familjaret jemi të shqetësuar jashtëzakonisht dhe lidhur me këto ngacmime e kam njoftuar kryeprokurorin e prokurorisë themelore në Prizren duke e respektuar parimin e hirësisë, pastaj kam njoftuar kryeprokurorin e prokurorisë së Kosovës z. A.. L., gjithashtu kam njoftuar edhe kryetarin e komisionit pran këshillit prokurorial i cili komision është i formuar lidhur me trajtimin e kanosjeve ndaj prokuroreve dhe për këtë kanosje e kam njoftuar këtë si kryetar. Tutje i dëmtuari ka deklaruar se: lidhur me këto shqetësime ndaj meje është iniciuar vetëm, ky rast për të cilin jemi këtu, dhe nuk e kam par te arsyeshme që për çdo reagim ose shkrim të tij të hapim raste të reja, aq më tepër reagimet e tija nuk përfundojnë vetëm përmes shkrimeve të tilla të them ngase para disa muajve gjatë sezonit të verës vajza ime ka shpreh shqetësimin se dikush nga rruga e ka përcjell deri në momentin kur ajo ka hyr në shtëpi, për këtë e njëjta me ka njoftuar kur jam kthyer nga puna e kam pyet në detaje se a njeh këtë person dhe si duket ndër shenjat karakteristike më ka përshkruar se i njëjti ishte tullac pa flok, dhe pasi i kam prezantuar foton e të pandehurit me siguri të plotë ka vërtetuar se atë e kishte ndjek ky***

person, dhe ky rast ka ndodh ne vitin 2023 ne stinën e verës. **Tutje i dëmtuari ka deklaruar se:** i pandehuri ka shkruar ne llogari te fëmijëve te mijë mesazhe kanosëse, duke ju thënë se ne qoftë se nuk shukatet babi juaj unë do te merrem me ju, i pandehuri ne periudhën për te cilën akuzohet prej vitit 2016 ne vazhdimësi duke komentuar me ka shqetësuar dhe rasti i fundit ne gazetën SINJALI ku komenton: ama qaq qen janë këta ne Prizren saqë se pret kush vetingun, unë disa gjyqtareve dhe prokuroreve ne Prizren kom qefë me jau mbarsu familjen , disave duhet me jau mbarsu grat ne hotele, vajzat ne park dhe nënat ne varr, kjo është në vitin 2024, prandaj gjykata ka ardhur ne përfundim se:

-nga dëgjimi i të dëmtuarit gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë element te veprës penale për te cilën akuzohet i pandehuri, e ne aspektin e vërtetimit te këtyre elementeve gjykata dëshminë e të dëmtuarit e ka vlerësuar si dëshmi qartazi te pa mbështetshme ngase vetë i dëmtuari ka deklaruar se unë nuk kam llogari të rrjetit social facebook, e po ashtu nga vet dëshmia e tij është vërtetuar se i pandehuri nuk ka thirr ne telefon, nuk i ka shkruar sms, nuk i është shfaq te shtëpia, shkolla, puna apo qendra rekreative, nuk i ka dërgimin apo lënë porosi; letra postare apo postë elektronike; ose lënien apo dërgimin e dhuratave të padëshiruara apo të gjësendeve tjera.

Ndërsa gjykata pas vlerësimit të provave materiale ka konstatuar së nuk është kontestuese e i pandehur ka komentuar ne vazhdimësi në Betimi për Drejtësi, tek E.. E.. C.., në Prizrenpress's tek R.. B..., tek A.. K.., në Betimi, në portalin P....info, tek.. R.. B.., tekë S.. K.., duke përdorur fjalë fyese dhe ofenduese ndaj të dëmtuarit.

Prandaj meqenëse deklarata e dëmtuarit nuk është mbështetur ne asnjë provë materiale dhe nuk ka ndërlidhej me provat e tjera qoftë personale apo materiale gjykata ka vendosur për lirimin e të pandehurit nga aktakuza nga se nga ekzaminim i telefonit të të pandehurit E.. Q.., i llojit S.. D... ngjyrë e b.. IMEI 1 3../.. dhe IMEI 2: 3...../.. nga raporti i ekspertizës nuk është vërtetuar se i pandehuri ka ndërmarr ndonjë veprim për të cilin gjykata do të mundë të merrte aktgjykim dënues, ngase ne këtë raport është konstatuar se i pandehuri ka kontaktuar me persona të ndryshëm rreth rasteve të tij, dhe po ashtu ne këtë raport të ekspertize të dt. 08.01.2020 janë cekën karakteristikat e telefonit.

Fakti se i pandehuri ka komentuar ne mënyrë të vazhdueshme ndaj të dëmtuarit me komente fyese dhe ofenduese edhe pse aktakuza nuk e ka përcaktuar sakte se kur janë bërë ato komente, gjykata ka vlerësuar se këto veprime nuk përbejnë vepër penale, sepse nuk e përmbushin asnjërin nga elemente e kërkuara me nenin 182 të KPRK-së, prandaj gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me raport juridiko-civil që rregullohet sipas ligjit civil kundër fyerjes dhe shpifjes.

Gjykata duke vlerësuar mbrojtën e te akuzuarit duke e krahasuar me dëshminë e të dëmtuarit dhe provat materiale i ka falur në tersi besimin ngase i pandehuri ne mbrojtjen i ka pranuar veprimet e bëra por ka theksuar se këto veprime nuk përbejnë vepër penale, e duke marr parasysh se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e

ndonjë dispozite te ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

6. Vendimi për lirimin e të akuzuarve nga akuza

Lidhur me pretendimet e Prokurorisë se i akuzuari ka kryer veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata pas administrimit te provave, ka vlerësuar me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata konform nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.3 të KPPRK-së të njëjtin e liroj nga akuza sepse akuza ka mbetur nën nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe jo në atë të bazuar mirë në prova të artikuleshme dhe të besueshme se i akuzuari me veprimin e tij të ketë kryer veprën penale për të cilin ngarkohet.

Me dispozitën ligjore te nenit 3 par. 2 te KPPRK-se është përcaktuar se: mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve te rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite te ligjit penale interpretohen ne favor te të pandehurit dhe te drejtave te tij sipas Kodit dhe sipas Kushtetutës se Republikës se Kosovës, andaj meqenëse ne rastin konkret te gjitha provat e administruara e dëshmojnë pafajësinë e te akuzuarit, për veç deklaratës së të dëmtuarit e cila nuk e ka mbështetur në prova të tjera dhe në kundërshtim me deklaratën e të pandehurit, e në kuptim te nenit 8 par. 1 dhe 2 te KPPRK-se gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimit

Me dispozitën ligjore të nenit 7 të KPRK-së është përcaktuar se: gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.

Me dispozitën ligjore të nenit 8 të KPRK-së është përcaktuar se: gjykata në punën e saj është e pavarur dhe vendos në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Gjukata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor. Prandaj asnjë nga provat e verifikuara ne shqyrtim gjyqësore nuk është vërtetuar se i pandehuri i ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar nga ana e Prokurorisë.

7.Lidhur me kërkesën pasurore-juridike

Komfor nenit 462 par. 3 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e udhëzoi në kontest civil.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar nënin 453 paragrafi 1 të KPP-së.

9. Vendimi për kthimin e sendit

Gjykata ka vendosur që të pandehurit të kthej telefonin S.. D.. ngjyrë e b.. IMEI 1 3../.. dhe IMEI 2: 3../.. menjëherë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nga se në rastin konkret gjykata ka gjetur se nuk ka bazë ligjore për konfiskim të përhershëm të këtij sendi, meqenëse nga ekzaminimi i këtij telefoni ka dalë që i njëjta ka mundësuar kryerjen veprës penale për çka gjykata ka marrë edhe aktgjykim lirues, e po ashtu ky send nuk është i përfituar me kryerjen e veprës penale, dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë bazat për konfiskim nga neni 276 i KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2019:274649, 02.04.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Edona Berisha Kastrati

G j y q t a r i

Musë POVATAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.